

Emri i Lëndës : Hyrje në Sociologji							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ISC 321	A	Vjeshtë	2.00	0.00	0.00	2.00	3.00
Lektori		Genti Kruja, Prof. Asoc. Dr.					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip, Anglisht, Turqisht					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Programi i lëndës “Hyrje në Sociologji” përmban një tërësi konceptesh, njohurish dhe vlerash, të lidhura logjikisht me njëra-tjetrën për të interpretuar më mirë dukuritë, proceset dhe tendencat e zhvillimit të shoqërisë bazuar në analizën sociologjike. Studenti do të njihet me metodat e ndryshme kërkimore, ku përfshijmë eksperimentin sociologjik, anketat, intervistat, vëzhgimin sociologjik etj. Studimi shkencor duhet të analizojë kontekstin kulturor duke i kushtuar vemendje të vecantë simboleve, normave, materiales, subkulturës, kundërkulturës, etnocentrizmit, ksenocentrizëm, relativitetit kulturor, shoqërizimit etj.					
Objektivat		1. T’u ofrojë studentëve aftësimin intelektual për të analizuar dukuritë, proceset e zhvillimet më të rëndësishme të shoqërisë; 2. Të ketë njohuri bazë të kërkimit shkencor sasior dhe cilësor. 3. Të kultivojë aftësitë për t’u angazhuar në zgjidhjen praktike të problemeve të ndryshme shoqërore që kanë të bëjnë me individin, me grupime shoqërore të caktuara ose me gjithë shoqërinë; 4. Të rrisë vetëdijen dhe përkushtimin për respektimin e vlerave, normave kulturore e ligjore si kusht i domosdoshëm për bashkëjetesën në shoqërinë bashkëkohore dhe të impenjohet në promovimin e tyre.					
Konceptet Kryesore		Ndër konceptet kryesore që do të shtjellohen në kuadrin e këtij programi janë: faza të procesit të shoqërizimit, devianca, dallimi gjinor, shtresimi ekonomik, familja, raca, etnia, pakica kombëtare, diskriminimi racor ose etnik, feja. Lënda do paraqesë një pasqyrë të gjerë të funksioneve sociale dhe ideologjive si, fe botërore, shekullarizim, fundamentalizëm, karakteristika të punës në vendet më të industrializuara, urbanizim, metropol, megalopolis, zonë urbane, xhentrifikim, lëvizshmëri shoqërore individuale, lëvizshmëri shoqërore strukturore, shoqëri tradicionale, shoqëri moderne, shoqëri pasmoderne etj					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Sociologjia, probleme dhe perspektiva Ç’është Sociologjia? Disa shembuj - Ndryshimi në botën e sotme - Sociologjia dhe “mendimi empirik”. Probleme sociologjike - Pasojat e qëllimshme e të paqëllimshme të veprimit njerëzor - Ç’mund të na tregojë sociologjia për veprimet tona? - Struktura dhe veprimi - Të zhvillosh një këndvështrim sociologjik - A është sociologjia shkencë? - Objektiviteti - Rëndësia praktike e sociologjisë - Komente përfundimtare - Përmbledhje - Koncepte bazë - Terma të rëndësishëm. Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:21.						

2	2.1. Kultura dhe shoqëria Kontaktet midis kulturave; Lidhjet e hershme me kultura të ndryshme; Koncepti i Kulturës. Koncepti i kulturës është një nga nocionet më të përdorura në sociologji. Kultura përbëhet nga vlerat, që u përmbahen anëtarët e një grupi, nga normat që ata respektojnë dhe nga të mirat materiale që kanë. “Kultura” si koncept dallohet nga “shoqëria”, por midis dy nocioneve ka lidhje të afërta. Shoqëria është sistemi i marrëdhënieve reciproke që lidhin me njëri-tjetrin individët e së njëjtës kulturë. Raca njerëzore; Sociobiologjia; Instinktet; Shumëllojshmëria kulturore; Identiteti kulturor dhe etnocentrizmi; Universalet kulturore; Gjuha; Të folurit dhe të shkruarit; Semiotika dhe kultura materiale; Llojet e shoqërive njerëzore. Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:41. 2.2. Shoqërizimi dhe periudhat e jetës Fëmijët “e pashoqëruar”; Zhvillimi i hershëm i fëmijës; Zhvillimi i reagimeve sociale; Teoritë mbi zhvillimin e fëmijës; Frojdi dhe psikoanaliza; Zhvillimi i personalitetit; Teoria e Mead-it; Lidhjet midis teorive; Faktorët e Shoqërizimit. Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:69.
3	3.1. Bashkëveprimi social dhe jeta e përditshme Studimi i jetës së përditshme sociale; Komunikimi verbal dhe joverbal; Rregullat sociale, bisedat dhe të folurit; Menaxhimi i përshtypjeve; Organizimi i përshtypjeve; Llojet e bashkëveprimit; Ndarja e audiencës; Etno-metodologjia; Studimi i të folurit; Analiza e bisedimeve; Mikrosociologjia; Koha dhe hapësira; Zonat balllore dhe të prapavijës; Takimet dhe hapësirat personale; Ndërveprimi në kohë dhe hapësirë; Koha dhe ora; Gjeografia e kohës; Ndarja në zona. Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:97. 3.2. Konformizmi dhe shmangia Normat dhe sanksionet; Ligjet, Krimet dhe ndëshkimi; Teoritë biologjike dhe psikologjike mbi krimin dhe shmangien; Shoqëria dhe krimi: teoritë sociologjike; Teoria e etiketimit; Përfundime teorike. Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:122.
4	4.1. Sociologjia e fesë Sociologjia e religjionit është studimi i besimeve, praktikave dhe formave organizative të fesë duke përdorur mjetet dhe metodat e disiplinës së sociologjisë. Çfarë është feja? Historia e feve: Besimet abrahamicke dhe monotesite - Jadaizmi, Krishterimi, Islami; Besimet tjera: Budizmi, Hinduizmi, Konfucianizmi, etj.; Teoritë e fesë; Tipet e organizimit fetar; Rituale; Përkatesia gjinore; Zhvillimet aktuale të fesë; Teoritë bashkëkohore të fesë; Liria e besimit; Feja në Shqipëri. Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:430. 4.2. Një vështrim sociologjik mbi dialogun ndërfeetar Dialogu ndërkulturor dhe ndërfeetar sot më shumë se kurrë është një domosdoshmëri globale. Procesi i dialogimit ndërfeetar nuk do të thotë njëkohësisht proces i kristianizimit, islamizimit, apo tjetërsimit, por është komunikim i vazhdueshëm popujsh, kulturash e traditash. Shembuj të tolerancës përgjatë historisë: Marrëdhëniet mes Islamit dhe Krishtërit; Dialogu teologjik; Një vështrimin historik mbi mirëkuptimin ndërfeetar tek shqiptarët; Shembuj të bashkëpunimit ndërfeetar në Shqipëri. Kruja, Genti, Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërfeetar, Prizmi, Tiranë, 2008:18, 131.
5	Shtresimi, Klasa dhe Pabarazia Shtresimi social është pabarazia e strukturuar ndërmjet grupeve. Kjo pabarazi mund të bazohet në ekonomi, gjini, racë, fe, moshë, apo ndonjë faktor tjetër. Sistemet e pabarazisë janë të organizuara rreth grupeve me karakteristika të përbashkëta. Vendndodhja sociale e një grupi është e rëndësishme në kuadër të shanseve jetësore të anëtarëve. Renditja e grupeve ndryshon shumë ngadalë. Temat e këtij leksioni janë: Shtresimi social; Karakteristikat e sistemeve të shtresimit; Modelet Bazë; Sistemi i Klasave; Si duken sot sistemet e shtresimit; Marksi dhe konflikti klasor; Weber: Klasa dhe statusi; Qasjet Funkcionaliste; Çfarë është klasa sociale; Raca dhe pasuria; Pabarazia sociale; Prestigji Profesional; mobiliteti social; Varfëria; Varfëria dhe Gjinia; Varfëria dhe problemet sociale. Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:211.
6	6 Etniciteti dhe Raca Raca i referohet një sistemi të kategorizimit shoqëror dhe shtresimit të imponuar nga jashtë. Nuk ekziston asnjë racë e vërtetë biologjike; përkundrazi, grupet njerëzore duhet të vendosen në një vazhdimësi. Në mënyrë tipike, raca i referohet një grup karakteristikash fizike, që shoqëria i quan të rëndësishme. Raca është një koncept shoqërisht i ndërtuar. Temat e këtij leksioni janë: Cilat janë racat më të paragjykuara dhe pse; Pakicat etnike; Raca dhe biologjia; Racizmi; Koncepte të lidhura me racizmin; Antagonizmi, paragjykim dhe diskriminimi etnik; Personaliteti autoritar; Etnia dhe fëmijëria; Grupet e sjelljes ndaj pakicave; Opsionet Etnike; Koncepte sociologjike; Kolonializmi dhe Racizmi; Modele të bashkëekzistencës etnike; Migrimi; Popullsia Raciale dhe Etnike; Pabarazia racore dhe etnike. Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:247.

7	Edukimi, komunikimi dhe media Sot në vendet e industrializuara çdo njeri mund të lexojë dhe shkruajë. Jeta jonë ndikohet nga informacionet që marrim nëpërmjet librave, gazetave, revistave, TV dhe internetit. Të gjithë kalojmë një proces zyrtar shkollimi. Fjala e shtypur, komunikimi elektronik dhe shkollimi janë themelore për mënyrën tonë të jetesës. Temat e këtij leksioni janë: Edukimi; Zhvillimi i shkrimit; Llojet e sistemeve të shkollave; Edukimi dhe pabarazia; Inteligjenca; Përkatesia gjinore dhe sistemi arsimor; Arsimi në botë; Komunikimi dhe media; Komunikimet masive: Gazetat, Revistat, Televizioni; Ndikimi i TV mbi sjelljet; Dhuna në TV, Ndikimi i dhunës dhe dialogjeve vulgare të filmave televizivë në modelet e sjelljeve të dhunshme në familjet shqiptare. Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:401; Revista shkencore “Zani i Naltë”, nr. 2 (155), 2013:66.
8	Provimi gjysmë final.
9	Familja, farefisnia dhe martesë Familja; Konceptet Familjare; Teoria dhe Familja; Farefisnia dhe Martesa; Klanet; Marrëdhëniet familjare; Llojet e familjes; Monogamia dhe poligamia; Poligjinia; Familja dhe martesë në Evropë; Familja nga vitet 1500-1800; Ndryshimet në familje; Format e ndryshimit në familje; Gratë dhe familja sot; Divorci, Divorci dhe pasojat, Divorci në Shqipëri; Rimartesa; Familjet me një prind; Faktorët që rrezikojnë divorcin; Dhuna në familje; Alternativat për martesën dhe familjen, martesë Brenda një gjinie; Bashkëjetesa; Beqaria; Ndarja e punës në familje; Trendet në familjet sot; Ndryshimet në familjet në mbarë botën; E ardhmja e familjes. Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:371.
10	Puna dhe Jeta Ekonomike Puna është përmbushja e detyrave, duke përfshirë harxhimin e përpjekjeve mendore dhe fizike, të cilat kanë për objektiv prodhimin e të mirave dhe kryerjen e shërbimeve, që plotësojnë nevojat e njeriut. Sistemi i prodhimit dhe puna; Ndarja e punës; Sektorët parësorë, dytësorë dhe të tretë; Tejlirizmi dhe fordizmi; Postfordizmi dhe prodhimi fleksibël; Demokracia industriale; Korporatat; Zhvillimi i sindikatave; Grevat; Statistikat e grevave; Papunësia dhe puna e grave; Karakteristikat e papunësisë; Arsyet e rritjes së papunësisë; Gratë dhe puna; Ekonomia jozyrtare; Puna dhe Jeta Ekonomike; Rëndësia e Punës; Ekonomitë kapitaliste; Korporatat Moderne; Biznesi Global; Ndryshimet në ekonomi; E ardhmja e punës. Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:462.
11	Globalizimi i jetës sociale Temat Kryesore: Të përcaktojmë globalizimin; Të kuptojmë lidhjen e globalizmit me modernen dhe ndryshimet e mëdha sociale; Të analizojmë lëvizjet sociale; çfarë janë dhe pse janë globale; Të zbulojmë cilat forca sociale çuan në rritjen e globalizmit; Formimi i kombeve; Arsyet e kolonizimit; Varfëria; Agrobiznesi Prodhimi ushqimor dhe ekologjia e mjedisit; Imperializmi; Teoria e sistemit botëror; Korporatat shumëkombëshe; Llojet e korporatave shumëkombëshe; Integrimi ekonomik ndërkombëtar; Organizmat joshtetërorë; OKB; Rreziqet ndaj mjedisit botëror; Globalizimi i medias; Globalizimi dhe ndryshimi social; Lidhja e globalizimit me ndryshimin social; Lëvizjet sociale dhe ndryshimi social; Teknologjia moderne dhe lëvizjet shoqërore; Çfarë e mundëson globalizimin; Çfarë e mundëson globalizimin; Globalizimi në jetën e përditshme; Debati mbi globalizimin; Si ndihemi ne në lidhje me globalizimin; Rreziku në një botë globale. Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:495.
12	Lufta dhe ushtria Luftërat në Evropë dhe në kolonitë e saj; Lufta e përgjithshme; Lufta e Parë Botërore; Tanku dhe zbulimet ushtarake në Luftën e I Botërore; Lufta e II Botërore; Lufta dhe agresioni; Organizimi ushtarak; Karakteristikat e ushtrisë modern; Gratë dhe lufta; Fushatat e grave kundër luftës; Ushtria, politika dhe shoqëria; Armatimi sot; Forcat e armatosura në Botën e Tretë; Terrorizmi; Lëvizjet guerrile; Tregtia dhe gara e armatimeve; Lufta e yjeve. Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:336.
13	Urbanizimi, Popullsia, dhe Mjedisi Si janë formuar qytetet dhe pse; Jetesa rurale, urbane dhe periferike; Globalizimi dhe urbanizimi; Rritja e popullsisë dhe pasojat e saj; Globalizimi, urbanizimi, rritja, dhe mjedisi; Qytetet e lashta; Çfarë është urbanizimi; Urbanizimi global; Teoritë e Urbanizmit; Jeta rurale; Popullsia rurale në rënie; Zhvillimi Periferik; Problemet me jetën urbane; Rinovimi urban; Qytetet globale; Urbanizimi në botën në zhvillim; Urbanizimi në botën në zhvillim; Studimi i popullsisë globale; Pasojat e ndryshimit të popullsisë; Mjedisi dhe shoqëria; Mjedisi dhe shoqëria. Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:529.
14	Politika, qeveria dhe shteti Karakteristikat e shteteve, shtetet moderne; partitë politike dhe votimet në vendet perëndimore; Politikat partiake: thyerja e kornizave; në fund të shekullit të XX; Pjesëmarrja e grave në politikë; Veprimtaria politike e painstitucionalizuar; Demokracia; Elitizmi demokratik dhe teoritë pluraliste; Kush sundon; Politika në arenën ndërkombëtare, Konceptet bazë; Terma të rëndësishme; Literaturë plotësuese. Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:298.

15	Metodat dhe teoritë në Sociologji - Zhvillimi i mendimit sociologjik Teoria sociale: Teoritë sociale përpiqen të shpjegojnë jo atë çka ndodh por pse ajo ndodh. Kërkimi dhe teoria nuk janë dhe nuk duhet të jenë industri të ndara nga njëra tjetra. Teoricienët e Parë: Auguste Comte, Émile Durkheim, Karl Marx, Max Weber, Harriet Martineau, W.E.B. Du Bois. Teoritë Bashkëkohore: Bashkëveprimi simbolik, Funkcionalizmi Metodat Kërkimore: Pyetjet Giddens, Anthony, Sociologjia, Çabej, Tiranë, 2007:629.			
16	Final Exam			
Parakushtet		Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.		
Literatura		• Giddens, Anthony; Duneier, Mitchell; P. Appelbaum, Richard, Sociology, W.W. Norton & Company, 2012.		
Referenca të tjera		• Durkheim, Emile, Sociological lectures. • Durkheim, Emile, Sociological lectures.		
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat				
1	Studenti duhet të ketë kuptuar kompleksitetin e realitetit shoqëror nëpërmjet udhëzimit të literaturës shkencore.			
2	Të ketë ezauruar mënyrat operative si dhe metodat empirike të implementimit ideologjik.			
3	Të jetë i aftë të interpretojë tekste të kontekstit sociologjik.			
Mënyra e Vlerësimit të Lëndës				
Notat e Ndërmjetme		Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale		1	30	
Kuize		0	0	
Projekte		0	0	
Projekte semestrare		1	20	
Punë laborator		0	0	
Pjesëmarrja në mësim		0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50	
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50	
Total			100	
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)				
Aktivitetet		Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)		16	2	32
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)		14	3	42
Detyra		1	2	2
Gjysmë finale		1	2	2
Provimi final		1	2	2
Të tjera		0	0	0
Ngarkesa totale e orëve				80
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)				3.20
ECTS				3.00